

VENDIM
Nr.929, datë 21.12.2011

**PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “KURUM INTERNACIONAL” SHA PËR
IMPORTIN E MBETJEVE METALIKE TË HEKURIT DHE TË ÇELIKUT, PËR
QËLLIME RICIKLIMI**

(Ndryshuar me VKM nr. 491, datë 1.8.2012)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr.10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “Kurum Internacional”, sh.a., për importin e mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, me kodet GA 720410, GA 720429, GA 720430, GA 720441, GA 720449 dhe B1-B1010, të Konventës së Bazelit, anekset 1 e 2 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit n.825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, për qëllime riciklimi, si më poshtë vijon:

- GA 720410 mbetje dhe kthime të gizës së derdhur;
- GA 720429 mbetje dhe kthime të çelikeve të lidhura;
- GA 720430 mbetje dhe kthime të gizës dhe çelikut të kallajisur;
- GA 720441 copa të vogla lëmimi, mbetje nga zbukurimet dhe stampimet, nëse janë apo jo në tufë.
- GA 720449 mbetje të fragmentizuara, ashkla.

2. Sasia e mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, që importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi është 600 000 (gjashtëqind mijë) tonë.

3. *Mbetjet importohen nga shtetet e Bashkimit Europian apo shtetet anëtare të Konventës së Bazelit, në rrugë tokësore ose detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr.806, datë 4.12.2003 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim.*

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, nga “Kurum Internacional” sh.a., të jetë për një afat kohor njëvjeçar, që do të fillojë me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore, merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të hekurit dhe çelikut, nga “Kurum Internacional” sh.a. pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon, me shkrim, me shtetet eksportuese dhe ato të kalimit transit të kësaj sasie të mbetjeve metalike të hekurit dhe të çelikut, në përmbushje të kërkesave të konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e

Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha